# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-434804**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | SPAK zbërthehen skemën e mashtrimit kompjuterik/ Burg për shqiptarët, si i fusnin në kurth qytetarët në disa shtete dhe u merrnin paratë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/10/spak-zberthehen-skemen-e-mashtrimit-kompjuterik-burg-per-shqiptaret-si-i-fusnin-ne-kurth-qytetaret-ne-disa-shteteve-dhe-u-merrnin-parate4/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 11:24:01 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 10 shtator 2026, 11:19:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 10 shtator 2026, 11:18:00 UTC → 10 shtator 2026, 11:20:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `306b45bc471e48d5d91f32ae80e23ab6ccd57310e7a38696c193447418898f85` |
| TEKSTI | `274d2779a91160e2a5127652437f312940ffc15c6925cfcf10aabb94cc5698f7` |
| PAMJA | `7c7c42fff55fc8295d27c8b5a1a2e87301bf7733043cb171847cf6c44126720b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d4c1c44329d91fc48fff5c2a5d0aa04a9b0ea2242228bacb2ea71729173eee21` |
| E MËPARSHMJA | `4e0ba25cec336ec27397abcd580f2a82cce75102edd5517adbc6739cefc81c1a` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d4c1c44329d91fc48fff5c2a5d0aa04a9b0ea2242228bacb2ea71729173eee21`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# SPAK zbërthehen skemën e mashtrimit kompjuterik/ Burg për shqiptarët, si i fusnin në kurth qytetarët në disa shtete dhe u merrnin paratë

10/09/2026 13:19

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në vazhdim të punës hetimore lidhur me procedimin penal nr.300/1 të vitit 2021, në kuadër të Skuadrës së Përbashkët Hetimore me Prokurorinë e Bambergut Gjermani, ekzekutoi 8 nga 11 masat e sigurisë ndaj shtetasve shqiptarë, të dyshuar si pjesëtarë të një grupi të strukturuar kriminal, që merrej me veprimtarinë e paligjshme të mashtrimit kompjuterik përmes shitjeve online.

Masat e sigurisë janë ekzekutuar, të mërkurën më 9.9.2026 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, si rezultat i veprimeve hetimore të nisura pas kontrolleve dhe sekuestrimeve të pajisjeve elektronike, më 16.3.2022, në subjektin, qendra e thirrjeve "Bluenergycall shpk", (Njësia Bashkiake nr.7, rruga e Kavajes, Condor Center, Tiranë).

**Masat e sigurimit të ekzekutuara janë si vijon:**

1. **Gj, G.Sh dhe E.P –** "Arrest me burg", si persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale;"Mashtrim kompjuterik", në bashkëpunim, në dëm të disa personave, në formën e grupit të strukturuar kriminal, "Grup i struktuar kriminal", "Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 143/b/2, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
2. **Gj. K. B. dhe I.G –** "Arrest në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, të dyshuar për vepren penale të "Mashtrimit kompjuterik", në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, "Grup i struktuar kriminal", "Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 143/b/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
3. **Gj dhe Dh.L –** "Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, si të dyshuar për veprat penale të "*Mashtrim kompjuterik*", në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 143/b paragrafi 2 të Kodit Penal.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar e regjistroi procedimin penal nr.300, më datë 9.12.2021 për veprat penale: "Mashtrim kopjuterik", të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar si vepër penale nga nenet 143/b, 28/4, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

Mbi bazën e kërkesës për ndihmë juridike të autoriteteve gjermane të drejtësisë, përkatësisht, Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme Bamberg dhe në zbatim të Vendimeve të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO) më 16.3.2022 janë kryer kontrolle në ambjentet e subjektit "Bluenergycall shpk" dhe subjekteve të lidhura me të.

**Skema e mashtrimit**

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.